

Të drejtat e romëve dhe të udhëtarëve në 13 vende evropiane: Perspektiva nga Anketa për Romët 2024

—

Përmbledhje

Ky botim u hartua në gjuhën angleze. FRA-ja nuk mban përgjegjësi për cilësinë e përkthimeve në gjuhë të tjera.

© Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2025

Riprodhimi autorizohet me kusht që të cilësohet burimi.

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotove apo materialeve të tjera, që nuk është sipas të drejtave të autorit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

As Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe as personat që vepronë për llogari të Agjencisë, nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2025

FRA – AGJENCIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

Schwarzenbergplatz 11 – 1040 Vienna – Austria

T +43 158030-0 – F +43 158030-699

fra.europa.eu

[linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency](https://www.linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency)

[instagram.com/fundamental.rights](https://www.instagram.com/fundamental.rights)

[facebook.com/fundamentalrights](https://www.facebook.com/fundamentalrights)

[youtube.com/EUAgencyFRA](https://www.youtube.com/EUAgencyFRA)

[x.com/EURightsAgency](https://www.x.com/EURightsAgency)

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| <i>Përse nevojitet kjo anketë?</i> | 4 |
| Nevoja për të dhëna: monitorimi i Kuadrit të BE-së për Romët..... | 6 |
| Raporti..... | 7 |
| <i>Gjetjet kryesore</i> | 10 |
| Diskriminimi kundër romëve për shkak të origjinës së tyre mbetet i lartë me kalimin e kohës | 14 |
| Ka më pak romë që jetojnë në varfëri, por sërish katër herë më shumë se populli i thjeshtë në BE-27..... | 16 |
| Pavarësisht rritjes së besimit te policia dhe sistemi ligjor, ka raportim jo të plotë të diskriminimit dhe ngacmimit nga ana e romëve. | 18 |
| Më shumë fëmijë romë janë të regjistruar në arsimin në fëmijërinë e hershme, por veçimi dhe diskriminimi vijojnë të jenë të pranishëm..... | 20 |
| Është rritur numri i romëve në punësim me pagesë, por janë rritur gjithashtu hendeku gjinor dhe diskriminimi | 22 |
| Hendeku i jetëgjatësisë ndërmjet romëve dhe popullit të thjeshtë është ulur..... | 24 |
| Kushtet e strehimit për romët po përmirësohen | 26 |
| <i>Përfundimet</i> | 28 |

Përse nevojitet kjo anketë?

Anketa për Romët 2024 ofron të dhëna të krahasueshme mbi ndikimin real të legjislacionit dhe politikave, në nivel kombëtar dhe BE-je, kundër diskriminimit, kundër racizmit dhe për barazinë (duke përfshirë politikën për reduktimin e varfërisë dhe përfshirjen sociale), për romët/udhëtarët (*Travellers*), si një grup specifik personash që zotërojnë të drejta. Të dhënat nga disa vende anëtare të BE-së mundësojnë analizimin e tendencave me kalimin e kohës. Kjo tregon mënyrën se si BE-ja dhe vendet e saj anëtare respektojnë detyrimet ligjore lidhur me të drejtat themelore të garantuara nga Traktati për Bashkimin Evropian, Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe [Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian](#), për sa i përket romëve/udhëtarëve.

Gjetjet e mëparshme nga anketat e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) sugjerojnë se romët dhe udhëtarët në mbarë BE-në, jo vetëm që përballen me shkelje të drejtpërdrejta të të drejtave të tyre themelore, ku përfshihen diskriminimi, veçimi, si dhe dhuna dhe ngacmimi me motiv urrejtjen, por edhe me shkelje të tërthorta të të drejtave të tyre të mbrojtura me ligj. Diçka e tillë konstatohet nga hendeku i konsiderueshëm midis romëve/udhëtarëve dhe popullit të thjeshtë për sa i përket parametrave kryesorë të arritjeve të tyre në arsim, punësim, shëndetësi dhe strehim.

Parimi i mosdiskriminimit është një parim themelor i të drejtës së BE-së. Nenet 2 dhe 6 të [Traktatit për Bashkimin Evropian](#) ⁽¹⁾ pranojnë shprehimisht barazinë dhe mosdiskriminimin si vlera themelore në kontekstin e BE-së.

Në vitin 2009, Traktati i Lisbonës prezantoi një klauzolë ndërlidhëse me qëllimin për të integruar luftën kundër diskriminimit në të gjitha politikën dhe masat e BE-së ([Neni 10 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#)) ⁽²⁾. Kjo e drejtë sanksionohet gjithashtu në nenin 21 të [Kartës së të Drejtave Themelore](#) që përcakton se "Ndalohej çdo lloj diskriminimi mbi baza të gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës etnike apo sociale, tipareve gjenetike, gjuhës, fesë apo besimit, mendimeve politike apo të llojeve të tjera, përkatësisë në një pakicë kombëtare, pronës, lindjes, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual" ⁽³⁾. Autoritetet përkatëse të vendeve anëtare kanë detyrimin që të veprojnë në përputhje me Kartën e të Drejtave Themelore gjatë zbatimit të legjislacionit të BE-së.

BE-ja pranon se shumë prej romëve që jetojnë në vendet anëtare mbeten të marginalizuar dhe përballen me diskriminimi, antixhipsizmi dhe përjashtimi socio-ekonomik. Të drejtat e tyre themelore janë në rrezik në disa fusha të jetës ⁽⁴⁾. Gjetjet e FRA-së e kanë evidentuar vazhdimisht këtë fakt duke përdorur të dhëna të plota

statistikore që nga viti 2008. Rezultatet e anketave të FRA-së në vitet 2008 ⁽⁵⁾, 2011 ⁽⁶⁾, 2016 ⁽⁷⁾, 2019 ⁽⁸⁾ dhe 2021 ⁽⁹⁾ tregojnë se përpjekjet e BE-së dhe të vendeve anëtare kanë rezultuar në një progres të kufizuar dhe të pabarabartë për sa i përket aksesit të romëve në të drejtat themelore.

Komunikata e Komisionit Evropian e vitit 2020 përcaktoi [Kuatrin Strategjik të BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen deri në vitin 2030](#), duke nxitur barazinë efikase, përfshirjen socio-ekonomike dhe pjesëmarrjen domethënëse të romëve ⁽¹⁰⁾. Komunikata u fokusua në trajtimin e katër objektivave lidhur me të drejtën për arsimim (neni 14 i [Kartës së të Drejtave Themelore](#)), punësim (e njohur si liria për të kërkuar punësim dhe punë) (neni 15 i [Kartës](#)), strehim (në veçanti e drejta për asistencë për strehim) (neni 34 i [Kartës](#)) dhe akses në kujdes shëndetësor (neni 35 i [Kartës](#)). Komunikata i kërkoi FRA-së të mbledhë dhe të sigurojë rregullisht të dhëna dhe informacion mbështetës mbi progresin drejt përfshirjes së romëve në vendet anëtare. Një vit më vonë, [Rekomandimi i Këshillit i vitit 2021 mbi barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve](#) ⁽¹¹⁾ u bëri thirrje vendeve anëtarëve që të shfrytëzojnë portofolin e treguesve ⁽¹²⁾, një kuadër monitorues i zhvilluar bashkërisht nga FRA-ja, Komisioni dhe vendet anëtare.

Politikat në nivel BE-je për trajtimin e përjashtimit dhe privimit të romëve parashikohen në [Kuatrin Strategjik të BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#) (referuar në vijim si kuadri i BE-së për Romët). Ky kuadër përcakton shtatë objektiva në nivel BE-je për periudhën deri në vitin 2030. Tre nga këta objektiva janë të ndërlidhur në fushat e barazisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes. Katër të tjerët janë objektiva sektoriale në fushat e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetit. Për t'u zbatuar në mënyrë efikase, këta objektiva duhet të mbështeten nga aftësia për të matur progresin ⁽¹³⁾.

Komunikata e vitit 2020 e vendos [Kuatrin e BE-së për Romët](#) në kontekstin e krijimit të një Bashkimi Evropian të barabartë. Ky kuadër i referohet shprehimisht parimeve të përgjithshme të mosdiskriminimit dhe barazisë të parashikuara në [Traktatin për Bashkimin Evropian](#) (nenet 2 dhe 3, paragrafi 3), [Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#) (nenet 8, 10, 19 dhe 67, paragrafi 3), [Kartën e të Drejtave Themelore](#) (nenet 20 dhe 21) ⁽¹⁴⁾ dhe legjislacionin dytësor të BE-së, si Direktiva 2000/43/KE, "Për barazinë racore" ⁽¹⁵⁾. Parimet dhe synimet e kuadrit përkohë gjithashtu me parimet e [Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale](#) ⁽¹⁶⁾.

[Kuatri i BE-së për Romët](#) pasqyron [Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#) (OZhQ) të Kombeve të Bashkuara dhe parimin e tyre gjithëpërfshirës "askush t mos mbetet pas" ⁽¹⁷⁾. BE-ja mund të bëjë progres në arritjen e OZhQ-ve duke adresuar situatën e romëve. Pika hyrëse të një rëndësie të veçantë janë OZhQ-të 1 dhe 2 (ulja e varfërisë

dhe urisë), 3 dhe 4 (shëndet i mirë dhe mirëqenie, si dhe arsim cilësor për të gjithë), 6 dhe 7 (aksesi në ujë të pastër dhe higjienë, si dhe në energji të përballeshme e të pastër), 10 dhe 11 (zvogëlimi i pabarazisë brenda shteteve dhe mes tyre, si dhe zhvillimi i qyteteve dhe komuniteteve gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme) dhe 16 (shoqëri paqësore, akses në drejtësi për të gjithë dhe institucione efikase, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse) ⁽¹⁸⁾.

FRA-ja përdor termin "romë" si term ombrellë ku përfshihen grupe të ndryshme si romë, sinti, kale, romanishel, bojash/rudari, egjiptianët e Ballkanit, grupet lindore (dom, lom dhe abdal), grupet si udhëtarët, jenishët dhe popullatat e përcaktuara sipas termit administrativ *Gens du voyage (udhëtarë/itinerantë)*, si dhe personat njerëzit që identifikohen si ciganë (xhipsi) ⁽¹⁹⁾. Ky përkufizim është në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian dhe me përkufizimin e Këshillit të Evropës. FRA-ja, ashtu si Këshilli i Evropës, ka shtuar termin "udhëtarë", sipas rastit, për të theksuar veprimet që lidhen specifikisht me ta.

Nevoja për të dhëna: monitorimi i Kuadrit të BE-së për Romët

Mandati i FRA-së është të ofrojë asistencë dhe ekspertizë lidhur me të drejtat themelore në BE. Një nga mënyrat për të përmbushur këtë mandat është duke pajisur institucionet dhe vendet anëtare të BE-së me informacion dhe të dhëna të rëndësishme, objektive, të besueshme dhe të krahasueshme mbi të drejtat themelore ⁽²⁰⁾. [Kuadri i BE-së për Romët](#) përcakton gjithashtu se Agjencia duhet të kryejë anketa të rregullta për romët për vitet 2020, 2024 dhe 2028, për të ofruar të dhënat e nevojshme për rezultatet fillestare, afatmesme dhe përfundimtare, duke pasqyruar çdo ndryshim në situatën e romëve.

Në vitin 2024, FRA-ja prezantoi një anketë për romët/udhëtarët që jetojnë në 10 vende anëtare (Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Portugalia, Rumania dhe Spanja) dhe në tre vende në proces anëtarësimi (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia).

Të gjitha vendet e mbuluara ishin përfshirë në anketat e mëparshme të FRA-së për romët [Anketa e dytë e BE-së për Pakicat dhe Diskriminimin (EU-MIDIS II) e vitit 2016, Anketa për Romët dhe Udhëtarët e vitit 2019 dhe Anketa për Romët e vitit 2021], me përjashtim të Shqipërisë, dhe të gjitha vendet strehojnë popullsi të konsiderueshme të romëve/udhëtarëve. Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë shtuar në anketë si

vende jo anëtare të BE-së, duke pasqyruar anëtarësinë e tyre si vëzhgues në Bordin Drejtues të FRA-së dhe duke marrë në konsideratë faktin që kanë popullsi të konsiderueshme romë. Vendet e përfshira në Anketën për Romët 2024 mbulojnë 86% të popullsisë së vlerësuar të romëve/udhëtarëve në BE dhe 54% të popullsisë së vlerësuar të romëve/udhëtarëve në Evropë ⁽²¹⁾.

Anketa synonte të ofronte të dhëna për të populluar treguesit kryesorë dhe dytësorë të [Kuatrit të BE-së për Romët](#) për t'u përdorur më pas për monitorimin e kuadrit. Për sa i përket metodologjisë dhe pyetësorit të përdorur, anketa është në përputhje me Anketën për Romët 2021, si dhe me anketat e mëparshme të FRA-së për romët (EU-MIDIS II, Anketa për Romët dhe Udhëtarët), çka mundëson analizimin e tendencave në treguesit kryesorë. Kjo duhet të ndihmojë vendet anëtare që të zhvillojnë më shumë masa të synuara në kuadrot e tyre kombëtare për romët, si dhe që të vlerësojnë nivelin e përmbushjes së objektivave të tyre. Anketa aktuale ofron të dhëna për vlerësimin e ndryshimeve në situatën e romëve/udhëtarëve në mesin e periudhës së zbatimit të [Kuatrit të BE-së për Romët](#).

Raporti

Objektivi kryesor i raportit është të sigurojë **evidenca për ushtrimin e të drejtave themelore nga romët/udhëtarët** në vendet e zgjedhura evropiane, si dhe të sigurojë **të dhëna për [Kuatrin e BE-së për Romët](#)** në mesin e periudhës së zbatimit. Si rezultat, struktura e raportit është në përputhje me shtatë objektivat e kuadrit:

- Luftimi dhe parandalimi i antixhipsizmit dhe diskriminimit;
- ulja e varfërisë dhe përjashtimit social për të mbyllur hendekun socio-ekonomik midis romëve dhe popullit të thjeshtë;
- promovimi i pjesëmarrjes përmes fuqizimit, bashkëpunimit dhe besimit;
- rritja efiqase e aksesit të barabartë në arsim të përgjithshëm cilësor dhe përfshirës;
- rritja efiqase e aksesit të barabartë në punësim cilësor dhe të qëndrueshëm;
- përmirësimi i shëndetit të romëve dhe rritja efiqase e aksesit të barabartë në kujdes shëndetësor cilësor dhe shërbime sociale cilësore;
- rritja efiqase e aksesit të barabartë në strehim të përshtatshëm e jo të veçuar, si dhe në shërbime bazë.

Për çdo objektiv, raporti mbulon treguesit kryesorë, të mbështetur nga treguesit e përzgjedhur dytësorë. Përveç paraqitjes së të dhënave për vitin 2024 për të gjitha vendet e mbuluara, raporti krahason të dhënat e vitit 2024 me ato të viteve 2021 dhe 2016 për vendet përkatëse, aty ku është e mundur. Të dhënat për Francën dhe Irlandën krahasohen me ato të Anketës për Romët dhe Udhëtarët 2019 (shënuar me një yll (*) te figurat). Analiza e tendencave shikon ndryshimin në raport me vitin 2016 (me vitin 2019 për Francën dhe Irlandën). Këto vlera u përdorën në përcaktimin e [Kwadrit të BE-së për Romët](#), dhe objektivat numerike të kwadrit bazohen në këto vlera. Duke pasur parasysh nivelin e kufizuar të krahasueshmërisë së të dhënave të viteve 2024 dhe 2021 për Italinë për shkak të një ndryshimi në metodologjinë e anketës dhe mungesën e të dhënave për Italinë në vitin 2016, raporti nuk analizon tendencat në Itali.

Anketa për Romët 2024 ofron gjithashtu të dhëna për udhëtarët në Irlandë dhe për *Gens du voyage (itinerantët)* në Francë. Ekzistojnë dallime në terminologjinë e përdorur për grupet e studiuara, por për hir të qartësisë, figurat dhe tabelat në raport përdorin vetëm termin "romë" në legjendë kur paraqiten gjithashtu vlerat për popullin e thjeshtë. Në rastin e Francës, termi përfshin udhëtarët. Në rastin e Irlandës, raporti paraqet veçmas rezultatet për udhëtarët dhe romët për të ekzaminuar tendencat që nga viti 2019, periudhë në të cilën u intervistuan në Irlandë vetëm udhëtarët. Raporti përdor vetëm termin "romë/udhëtarë" kur i referohet informacionit lidhur me të gjithë Anketën për Romët 2024. Raporti përdor termat "romë" ose "udhëtarë" kur i referohet vendeve individuale, në varësi të popullsisë së mbuluar në ato vende.

Raporti i referohet vlerës mesatare për BE-në (totali i BE-së). Totali i BE-së përfshin mesataren e ponderuar të të gjitha vendeve anëtare të mbuluara në anketat përkatëse (të shënuara me dy yje (**)) te figurat). Për secilën anketë, totali i BE-së i referohet vendeve të mëposhtme.

- Totali i BE-së lidhur me Anketën për Romët 2024 mbulon 10 vende anëtare: Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Portugalia, Rumania dhe Spanja. Vlerat e ponderuara bazohen në madhësinë e popullsisë rome/udhëtare të mbuluar në Anketën për Romët 2024.
- Totali i BE-së lidhur me Anketën për Romët 2021 përfshin 10 vende anëtare të mbuluara në vitin 2021: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Greqia, Hungaria, Italia, Portugalia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Vlerat e ponderuara bazohen në madhësinë e popullsisë rome të mbuluar në Anketën për Romët 2021 dhe në anketat kombëtare për romët në Bullgari dhe Sllovakia.
- Totali i BE-së lidhur me Anketën për Romët 2016 mbulon nëntë vende anëtare: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Greqia, Hungaria, Portugalia, Rumania,

Slovakia dhe Spanja. Vlerat e ponderuara bazohen në madhësinë e popullsisë rome të mbuluar në EU-MIDIS II në vitin 2016.

- Totali i BE-së për popullin e thjeshtë mbulon 27 vendet anëtare të BE-së (BE-27). Vlerat e ponderuara bazohen në madhësinë e popullit të thjeshtë. Burimi i vlerave për vitin më të fundit paraqitet poshtë çdo figure. Vlerat fillestare (nga viti 2018) për popullin e thjeshtë janë marrë nga [dokumenti analitik që shoqëron Kuadrin e BE-së për Romët](#) ⁽²²⁾.

Ky raport paraqet të dhënat e mbledhura nga FRA-ja në 10 vende të BE-së dhe në tre vende në proces anëtarësimi të mbuluara nga Anketa për Romët 2024. FRA-ja mbështet gjithashtu mbledhjen e të dhënave në nivel kombëtar për romët në vendet e tjera të BE-së. Rezultatet nga këto vende, si Slovakia, do të publikohen nga FRA-ja kur të jenë të disponueshme.

Gjatë interpretimit të vlerave të paraqitura në raport, duhen pasur parasysh gabimet e mundshme në kampionim. Për rrjedhojë, nëse diferenca midis vlerave tejkalon ± 5 pikë përqindjeje, kjo duhet të interpretohet sikur nuk ka ndryshim.

Raporti paraqet gjithashtu një tregues pamor mbi mënyrën se si duhet të interpretohen të dhënat mes viteve 2016 dhe 2024 për sa i përket tendencave:

- ~ tregon se nuk ka ndryshim të situatës
- ↓ ↑ tregon një tendencë pozitive (përmirësim) – në varësi të treguesit, kjo përkon me rritje ose ulje të vlerës
- ↓ ↑ tregon një tendencë negative (përkeqësim) – në varësi të treguesit, kjo përkon me rritje ose ulje të vlerës.

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet evidenca mbi mënyrën se si ushtrohen të drejtat themelore të romëve/udhëtarëve sipas legjislacionit të BE-së në vendet anëtare të përzgjedhura dhe në vendet në proces anëtarësimi. Të dhënat dhe interpretimi i tyre ilustron mënyrën se si pasqyrohen masat dhe veprimtaritë e institucioneve të BE-së dhe të vendeve individuale përgjegjëse, në ndryshimin e situatës së këtyre grupeve specifike personash që zotërojnë të drejta. Raporti krahason situatën e vitit 2024 me atë të vitit 2016 (me vitin 2019 për Francën dhe Irlandën). Këto vlera të viteve të mëparshme janë përdorur si referencë në përcaktimin e [Kudrit aktual të BE-së për Romët](#).

Të dhënat e Anketës për Romët 2024 (Figura 1) sugjerojnë se, mesatarisht, janë arritur përmirësime (në nivel BE-je) për romët/udhëtarët në 10 nga 16 treguesit kryesorë të propozuar nga [Kudri i BE-së për Romët](#). Kjo nënkupton se romët dhe udhëtarët tashmë kanë akses më të gjerë në disa të drejta krahasuar me vitin 2016, duke përfshirë në të drejtën për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe të familjes së tyre (përmirësim i pjesshëm); në të drejtën për arsimim (përmirësim i pjesshëm); në të drejtën për punësim (përmirësim i pjesshëm); si dhe në të drejtën për akses në kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të përfituar nga trajtimi mjekësor. Situata është përqësuar për sa i përket një treguesi (raportimi jo i plotë i diskriminimit). Nuk është vërejtur asnjë ndryshim në pesë tregues (përvoja e përgjithshme lidhur me diskriminimin, niveli arsimor, veçimi në arsim, hendeku gjinor në punësim dhe mbipopullimi). Nga këta, tre tregues, përkatësisht ata që lidhen me diskriminimin (në tërësi dhe në fushat individuale të jetës), me veçimin në arsim dhe me barazinë gjinore në punësim, lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e garantuara nga ligji për të drejtat themelore që mbështetet në [Kudrin e BE-së për Romët](#).


Të dhënat sugjerojnë se shumica e objektivave në nivel BE-je, të përcaktuar nga [Kudri i BE-së për Romët](#), për rritjen efikase të aksesit të barabartë në punësim cilësor dhe të qëndrueshëm, kanë gjasa të arrihen brenda vitit 2030. Të dhënat sugjerojnë gjithashtu se disa prej objektivave të caktuar në nivel BE-je nuk kanë gjasa të arrihen brenda vitit 2030, ku përfshihen:

- luftimi dhe parandalimi i antixhipsizmit dhe diskriminimit;
- ulja e varfërisë dhe përjashtimit social për të mbyllur hendekun socio-ekonomik midis romëve dhe popullit të thjeshtë;
- promovimi i pjesëmarrjes përmes fuqizimit, bashkëpunimit dhe besimit;
- rritja efikase e aksesit të barabartë në arsim të përgjithshëm cilësor dhe përfshirës;

- përmirësimi i shëndetit të romëve dhe rritja e aksesit të barabartë në kujdes shëndetësor cilësor dhe shërbime sociale cilësore;
- rritja e aksesit të barabartë në strehim të përshtatshëm e jo të veçuar, si dhe në shërbime bazë.

Për sa i përket shëndetit, varfërisë, përjashtimit social dhe strehimit, objektivat në nivel BE-je nuk kanë gjasa të arrihen brenda vitit 2030, pavarësisht përmirësimeve të fundit në treguesit përkatës. Kjo për shkak se kushtet fillestare ishin shumë të dobëta, çka nënkupton se do të duhet më shumë kohë për të arritur objektivat.

Figura 1 – Tendencat në situatën e romëve dhe udhëtarëve mes viteve 2016 dhe 2024 lidhur me treguesit kryesorë të Kuadrit të BE-së për Romët dhe gjasat për arritjen e objektivave në nivel BE-je



Shënim: Për treguesit kryesorë, ngjyra rozë tregon se nuk ka ndryshim, e ngjyra e gjelbër tregon përmirësim dhe ngjyra e kuqe tregon përkeqësim. Për objektivat në nivel BE-je, ngjyra e kuqe tregon se nuk ka gjasa që objektivat të arrihen brenda vitit 2030; ngjyra e gjelbër tregon se ka gjasa që objektivat të arrihen (në pjesën më të madhe të tyre) brenda vitit 2030. AKFH, arsimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme; NEET, jo të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim.

Asnjë vend anëtar nuk ka gjasa që t'i arrijë objektivat e caktuar në nivel BE-je për antixhopsizmin dhe diskriminimin, pjesëmarrjen ose shëndetin (Tabela 1). Të dhënat sugjerojnë se dy vende anëtare kanë gjasa t'i arrijnë objektivat në nivel BE-je për varfërinë dhe përjashtimin social (Bullgaria dhe Hungaria) dhe për arsimin (Bullgaria dhe

Italia). Katër vende anëtare kanë gjasa t'i arrijnë objektivat për punësimin (Bullgaria, Hungaria, Italia dhe Rumania) dhe për strehimin (Republika Çeke, Greqia, Italia dhe Spanja). Numri më i madh i objektivave ka gjasa të arrihet nga Bullgaria (për varfërinë dhe përjashtimin social, arsimin dhe punësimin) dhe nga Italia (për arsimin, punësimin dhe strehimin). Një vështrim më nga afër i objektivave individuale tregon se vendet anëtare hasin më shumë vështirësi me objektivat e lidhur me mbylljen e hendekut midis romëve/udhëtarëve dhe popullit të thjeshtë. Shtojca 1 paraqet një vlerësim të gjasave që vendet anëtare të mbuluara nga Anketa për Romët 2024 të arrijnë objektivat e BE-së, në nivel kombëtar.

Tabela 1 – Gjasat për arritjen e objektivave në nivel BE-je sipas vendit

| Objekivi | Totali i BE-së | BG | CZ | EL | ES | FR ^(a) | HU | IE ^(b) | IT | PT | RO |
|---------------------------------|----------------|----|----|----|----|-------------------|----|-------------------|----|----|----|
| Antixhopsizmi dhe diskriminimi | | | | | | | | | | | |
| Varfëria dhe përjashtimi social | | | | | | | | | | | |
| Pjesëmarrja | | | | | | | | | | | |
| Arsimi | | | | | | | | | | | |
| Punësimi | | | | | | | | | | | |
| Shëndeti | | | | | | | | | | | |
| Strehimi | | | | | | | | | | | |

^(a) Kampioni i Francës përbëhet nga *Gens du voyage (itinerantë)*.

^(b) Shembulli i Irlandës përbëhet nga udhëtarët (romët e intervistuar në Anketën për Romët 2024 në Irlandë nuk përfshihen në këtë analizë).

Shënim: Ngjyra e kuqe tregon se nuk ka gjasa që objektivat të arrihen brenda vitit 2030; ngjyra e gjelbër tregon se ka gjasa që objektivat të arrihen (në pjesën më të madhe të tyre) brenda vitit 2030.

Disponueshmëria e të dhënave të krahasueshme për periudha të ndryshme kohore mundëson rritjen e saktësisë në dokumentimin e situatës reale të romëve/udhëtarëve në vendet e anketuara. Të dhënat nga Anketa për Romët 2024 sugjerojnë gjithashtu se COVID-19 pati një ndikim të madh mbi romët ⁽²³⁾ në të gjitha vendet e anketuara. Të dhënat për vitin 2021 u mblodhën duke përdorur të njëjtën metodologji si në vitet 2016 dhe 2024, por situata në vitin 2021 ishte e pazakontë. Nga njëra anë, romët u prekën në mënyrë joproporcionale nga ndikimi i masave emergjente lidhur me pandeminë. Nga ana tjetër, këto masa (karantinimi dhe kufizimet e tjera) ndikuan në procesin e anketimit (duke e bërë më të vështirë aksesin në komunitetet rome) dhe në prioritetet e të anketuarve për sa i përket sfidave të përditshme me të cilat përballëshin. Si rezultat, treguesit e vitit 2021 (që paraqiten gjithashtu në këtë raport) shpesh dalin jashtë tendencës së konstatuar mes viteve 2016 dhe 2024. Ndërkohë, masat dhe politikat që u

zbatuan gjatë kësaj periudhe nga vendet individuale nuk mund të kishin ndikim të mjaftueshëm në kaq pak kohë për të shpjeguar ndryshimet e konsiderueshme mes viteve 2021 dhe 2024.

Të dhënat nga anketat e mëparshme të FRA-së janë kritikuar për shkak të ilustrimit jo të plotë të gamës së gjerë të situatave në të cilat gjendeshin romët dhe udhëtarët në vendet e anketuara. Megjithatë, duhet theksuar se gjetjet nga Anketa për Romët 2024 paraqesin një tablo mesatare të situatës së romëve dhe udhëtarëve. Situatat në të cilat gjenden romët/udhëtarët individualë mund të variojnë për mirë ose keq midis vendeve të anketuara dhe brenda këtyre të fundit.

Ky raport paraqet një panoramë të ndikimit të vazhdueshëm të antixhipsizmit dhe problemeve me të cilat përballen shumë romë dhe udhëtarë lidhur me aksesin në të drejtat e tyre themelore për punësim, arsimim, kujdes shëndetësor dhe strehim. Që nga Anketa e parë për Romët në vitin 2011, FRA-ja ka publikuar 160 opinione në botimet e saj që tregojnë përmirësime praktike që duhet të realizohen nga BE-ja dhe vendet anëtare individuale për të përmbushur detyrimet e tyre për sa i përket të drejtave themelore të romëve dhe udhëtarëve. Megjithatë, politikat janë etiketuar gjerësisht si të ngadalta dhe joefikase në trajtimin e sfidave të identifikuara në raportet e FRA-së dhe shumica e këtyre opinioneve të FRA-së mbeten të vlefshme. Në shtojcën 2 paraqitet një listë e botimeve me opinionet e FRA-së lidhur romët dhe udhëtarët.

Diskriminimi kundër romëve për shkak të originës së tyre mbetet i lartë me kalimin e kohës

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 1, synimi i Kuadrit të BE-së për Romët është që, brenda vitit 2030:

- të ulet me të paktën 50% përqindja e romëve që përjetojnë diskriminim; pra, të garantohet që më pak se 13% e romëve të përjetojnë diskriminim.

Në përgjithësi, romët/udhëtarët nuk shohin asnjë ndryshim për sa i përket përvojës së tyre lidhur me diskriminimin dhe ngacmimin për shkak të origjinës së tyre etnike. Synimi në nivel BE-je që më pak se 13% e romëve të përjetojnë diskriminim brenda vitit 2030 (përgjysmim i nivelit të konstatuar në vitin 2016) mund të mos ketë gjasa të realizohet brenda vitit 2030, duke qenë se nivelet aktuale janë më shumë se dyfishi i përqindjes së synuar. Përvojat mes grave dhe burrave variojnë mes vendeve. Romët/udhëtarët më të vjetër në moshë përjetojnë më rrallë diskriminim. Romët që jetojnë në lagjet jorome përjetojnë diskriminim më rrallë se ata që jetojnë në lagjet ku të gjithë ose shumica e njerëzve janë romë, veçanërisht në Shqipëri, Bullgari, Republikën Çeke, Itali, Portugali dhe Serbi.

- Një në tre të anketuar romë/udhëtarë (31%) janë ndjerë të diskriminuar për shkak të prejardhjes së tyre etnike gjatë 12 muajve përpara anketës, në të paktën një nga fushat e jetës në vijim: gjatë kërkimit për punë, ose në punë; në fushën e arsimimit (si studentë ose si prindër/kujdestarë të studentëve); në fushën e shëndetësisë; në fushën e strehimit; në zyrat e administratës ose në shërbimet publike; ose në shërbimet e tjera publike ose private, si p.sh. restorante, bare, klube nate, hotele, dyqane, ose transport publik. Kjo gjetje sugjeron se nuk ka ndryshim të konsiderueshëm në krahasim me vitin 2016, kur niveli i diskriminimit ishte 26%. Norma e diskriminimit është ulur në Greqi dhe Serbi, ndonëse shumë pak, ndërkohë që është rritur në Republikën Çeke, Francë, Irlandë, Maqedoni të Veriut dhe Portugali.
- Një në pesë të anketuar romë/udhëtarë (19%) kanë përjetuar të paktën një nga pesë format e ngacmimit me motiv urrejtjen gjatë 12 muajve përpara anketës, çka

konfirmon një tendencë pozitive në uljen e ngacmimit krahasuar me nivelin prej 30% të raportuar në vitin 2016. E njëjta tendencë vërehet në nivel kombëtar në Republikën Çeke, Francë, Greqi, Hungari dhe Rumani, ndërkohë një tendencë e kundërt është konstatuar në Maqedoninë e Veriut dhe Portugali.

Ka më pak romë që jetojnë në varfëri, por sërish katër herë më shumë se populli i thjeshtë në BE-27.

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 2, synimet e Kuadrit të BE-së për Romët janë që, brenda vitit 2030:

- të ulet me 50% hendeku i varfërisë midis romëve dhe popullit të thjeshtë dhe të garantohet që shumica e romëve të dalin nga varfëria;
- të ulet me të paktën 50% hendeku i varfërisë midis fëmijëve romë dhe fëmijëve të tjerë dhe të garantohet që shumica e fëmijëve romë të dalin nga varfëria.

[Kuatridi i BE-së për Romët](#) përcakton synime për objektivin 2 për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë, në përputhje me masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 34 të [Kartës së të Drejtave Themelore](#). Lufta kundër përjashtimit social parashikohet edhe në legjislacionin e BE-së, krahas legjislacionit të Këshillit të Evropës. Neni 153, paragrafi 1, i [Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#) parashikon se BE-ja duhet "të mbështesë dhe plotësojë aktivitetet e vendeve anëtare" për të luftuar përjashtimin social pa miratimin e masave me fuqi ligjore detyruese, bazuar në ushtrimin e kompetencave kombëtare dhe në parimin e subsidiaritetit nga ana e vendeve anëtare.

Në përgjithësi, romët/udhëtarët shohin përmirësime në krahasim me vitin 2016 dhe sidomos me vitin 2021 (gjatë pandemisë së COVID-19) në të gjithë treguesit kryesorë lidhur me varfërinë dhe përjashtimin social. Megjithatë, asnjëri nga të dy synimet në nivel BE-je për këtë objektiv nuk ka gjasa të arrihet brenda vitit 2030. Nuk ka ndryshime të dukshme në situatën midis grave dhe burrave. Rezultatet e anketës sugjerojnë se ekzistojnë tre faktorë që rrisin rrezikun e varfërisë dhe përjashtimit social: moshja, kufizimet në aktivitetet e përditshme për shkak të arsyeve shëndetësore dhe jetesa në zona ku të gjithë ose shumica e individëve janë romë/udhëtarë (sidomos dy faktorët e fundit kanë një ndikim të konsiderueshëm).

- Tre në katër romë/udhëtarë (70%) janë në rrezik varfërie: ata jetojnë në familje me të ardhura të ekuivalentuara (pas ndihmës ekonomike) më të ulëta se 60% e të ardhurave mesatare në vendin e tyre. Përqindja është ulur në mënyrë drastike

në krahasim me vitin 2016 (80%), në secilin vend. Megjithatë, ndryshimet midis nivelit të të ardhurave për romët dhe për popullin e thjeshtë mbeten të mëdha (në BE-27 niveli ishte 16% në vitin 2024 dhe 17% në vitin 2018).

- 77% e fëmijëve romë/udhëtarë nën 18 vjeç jetojnë në familje në rrezik varfërie. Kjo normë është më e ulët se në vitin 2016 (85%), por sërish shumë më e lartë se sa për fëmijët nga populli i thjeshtë (19% në BE-27 në vitin 2024 dhe 20% në vitin 2018).
- Një përqindje ndjeshëm më e vogël e romëve/udhëtarëve jetojnë në privim të rëndë material (37%), krahasuar me vitin 2016 (62%). Të dhënat tregojnë një tendencë negative vetëm në Irlandë (për udhëtarët) dhe asnjë ndryshim në Francë, Maqedoninë e Veriut dhe Portugali. Tendencë vazhdon drejt përmirësimit në vendet e mbetura. Megjithatë, të dhënat më të fundit të disponueshme për popullin e thjeshtë në BE-27 (6% në vitet 2020 dhe 2018) tregojnë hendeqe vazhdimisht të mëdha për sa i përket popullsisë romë/udhëtare. Ky tregues nuk monitorohet më nga Eurostat dhe është zëvendësuar nga norma e privimit material dhe social.
- Përqindja e fëmijëve romë/udhëtarë të grupmoshës 17 vjeç e poshtë dhe që jetojnë në privim të rëndë material është gjithashtu më e ulët (40%) se në vitin 2016 (66%). Normat në vendet e anketuara përgjithësisht janë ulur që nga viti 2016, me përjashtim të fëmijëve udhëtarë në Irlandë. Për krahasim, 7% e fëmijëve nga populli i thjeshtë në BE-27 ndodhen në të njëjtën situatë (të dhënat nga vitet 2020 dhe 2018).

Pavarësisht rritjes së besimit te policia dhe sistemi ligjor, ka raportim jo të plotë të diskriminimit dhe ngacmimit nga ana e romëve.

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 3, synimi i Kuadrit të BE-së për Romët është që, brenda vitit 2030:

- të dyfishohet përqindja e romëve që raportojnë rastet e diskriminimit, pra, për të garantuar që të paktën 30% e romëve të raportojnë rastet kur bien viktimat të diskriminimit.

Formulimi i objektivit pasqyron detyrimin e vendit anëtar që të garantojë ekzistencën e organeve kombëtare të cilat ofrojnë asistencë të pavarur për viktimat e diskriminimit për të ndjekur ankesat e tyre rreth diskriminimit, pa paragjykuar të drejtat e viktimave dhe të shoqatave, organizatave, apo të subjekteve të tjera ligjore, të garantuara në nenin 13 të [Direktivës 2000/43/KE](#), "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht racës ose origjinës etnike".

Romët/udhëtarët vazhdojnë të kenë raportim jo të plotë të rasteve të diskriminimit, madje edhe më të ulët se në vitin 2016. Bazuar në këtë tendencë negative, ka shumë pak gjasa që synimi në nivel BE-je të arrihet brenda vitit 2030. Edhe pse raportimi jo i plotë është i pranishëm në të gjitha popullsitë e romëve/udhëtarëve, niveli i ndërgjegjësimit mbi organet përgjegjëse për barazinë dhe besimi te policia dhe sistemi ligjor kombëtar ndryshojnë sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të lagjes ku jetojnë të anketuarit.

- Rastet e diskriminimit, si dhe të dhunës dhe ngacmimit me motiv urrejtjen, me të cilat përballen romët/udhëtarët në BE, mbeten, në një masë të madhe, larg syrit të institucioneve, duke përfshirë të organeve përgjegjëse për barazinë dhe autoriteteve ligjzbatuese që kanë detyrimin ligjor për të ndihmuar viktimat. Vetëm 6% e romëve/udhëtarëve viktimat të diskriminimit e kanë raportuar këtë fenomen, apo kanë paraqitur një ankesë mbi incidentin më të fundit të diskriminimit. Kjo është pak më shumë se një e treta e nivelit të vitit 2016 (16%). Kjo tendencë negative vijon në të gjitha vendet, përveçse në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Spanjë, ku përqindja ka mbetur e pandryshuar.

- Një në dy të anketuar romë/udhëtarë (46%) ka dëgjuar për të paktën një organ përgjegjës për barazinë, institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, apo zyrën e Avokatit të Popullit në vendin e tyre, çka konfirmon tendencën pozitive të konstatuar midis viteve 2016 (29%) dhe 2021 (50%). Është konstatuar një tendencë e përgjithshme pozitive në shumicën e vendeve, përveçse në Hungari dhe Serbi, ku përqindja nuk ka ndryshuar.
- Një në dy të anketuar romë/udhëtarë (49%) kanë besim te policia në vendin e tyre. Kjo shifër është më e lartë se në vitin 2016 (37%), por ndjeshëm më e ulët se në rastin e popullit të thjeshtë në BE (73%). Besimi te policia është ulur vetëm në Greqi, Irlandë (për udhëtarët) dhe Maqedoninë e Veriut. Dy në pesë të anketuar romë/udhëtarë (40%) kanë besim te sistemi ligjor në vendin e tyre. Kjo shifër ishte 29% në vitin 2016. Vlera për popullin e thjeshtë në BE-27 është 55%. Besimi te sistemi ligjor ka pësuar rënie vetëm në Greqi.

Më shumë fëmijë romë janë të regjistruar në arsimin në fëmijërinë e hershme, por veçimi dhe diskriminimi vijnë të jenë të pranishëm

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 4, synimet e Kuadrit të BE-së për Romët janë që, brenda vitit 2030:

- të ulët me të paktën 50% hendeku ndërmjet romëve dhe popullit të thjeshtë lidhur me regjistrimin në arsimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, si dhe të garantohet që të paktën 70% e fëmijëve romë të frekuentojnë sistemin parashkollor;
- të zvogëlohet me të paktën një të tretën hendeku në përfundimin e arsimit të mesëm të lartë dhe të garantohet që shumica e të rinjve romë të përfundojnë të paktën arsimin e mesëm të lartë;
- të garantohet që më pak se një në pesë fëmijë romë të frekuentojnë shkollat ku shumica apo të gjithë fëmijët janë romë.

Formulimi i objektivit i referohet detyrimit të vendeve anëtare për të siguruar të drejtën për arsimim, të garantuar nga neni 14 i [Kartës së të Drejtave Themelore](#), si dhe për të siguruar që kjo e drejtë të përfshijë mundësinë për të marrë arsimin e detyrueshëm falas. Në përputhje me nenin 51, paragrafi 2, [Karta](#) nuk synon të krijojë kompetenca të reja për BE-në, por të nxisë bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare dhe, “nëse është e nevojshme”, të plotësojë dhe mbështesë veprimet e tyre për arsimin në përgjithësi dhe në të gjitha nivelet, siç sanksionohet në nenin 149 të [Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#).

Në përgjithësi, krahasuar me vitin 2016 janë bërë përmirësime në situatën e romëve/udhëtarëve lidhur me arsimin në fëmijërinë e hershme. Megjithatë, në shumicën e vendeve është rritur veçimi i fëmijëve romë/udhëtarë. Të dhënat sugjerojnë se asnjë nga tre synimet në nivel BE-je për arsimin nuk ka gjasa të arrihen brenda vitit 2030. Treguesit për arsimin nuk ndikohen nga gjinia apo mosha, por romët/udhëtarët që jetojnë në zona ku ka pak ose aspak romë/udhëtarë të tjerë, arrijnë një nivel arsimor më të lartë dhe përjetojnë nivel më të ulët diskriminimi dhe veçimi në arsim.

- Një në dy romë/udhëtarë (53%) frekuentojnë arsimin në fëmijërinë e hershme. Edhe pse ka përmirësim krahasuar me vitin 2016 (42%), sërish kjo shifër është pothuajse sa gjysma e përqindjes për fëmijët nga populli i thjeshtë në BE (95% në vitet 2023 dhe 2018). Një tendencë pozitive është konstatuar në shumicën e vendeve të mbuluara, me përjashtim të Spanjës, ku të dhënat e Anketës për Romët 2024 konfirmojnë tendencë të kundërt me atë të identifikuar në Anketën për Romët 2021.
- Vetëm 32% e romëve/udhëtarëve të grupmoshës 20–24 vjeç kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm të lartë; kjo shifër përbën ndryshim të ulët krahasuar me vitin 2016 (28%). Për popullin e thjeshtë në BE-27, kjo shifër ishte 84% në vitet 2024 dhe 2018. Kjo përqindje është në rënie në Republikën Çeke, Greqi dhe Serbi, ndërsa në Bullgari, Hungari, Rumani dhe Spanjë është në rritje. Në vendet e tjera, situata nuk ka ndryshuar.
- Një në dy fëmijë romë/udhëtarë (46 %) arsimohet në një shkollë ku të gjithë ose pothuajse të gjithë nxënësit janë romë/udhëtarë. Kjo shifër ka ndryshuar shumë pak gjatë viteve të fundit (52% në vitin 2021 dhe 44% në vitin 2016). Tendenca është pozitive vetëm në Maqedoninë e Veriut, ndërsa shumica e vendeve të anketuara, ku përfshihen Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Greqia dhe Rumania, kanë shfaqur tendencë negative (pra një rritje të veçimit) që nga viti 2016.
- 14% e të anketuarve romë/udhëtarë janë ndjerë të diskriminuar për shkak të origjinës së tyre etnike gjatë 12 muajve përpara anketës në rastet kur kanë pasur kontakt me një institucion arsimor, qoftë si studentë apo si prindër/kujdestarë të një fëmije. Kjo përqindje është më e lartë se në vitin 2016 (7%). Të gjitha vendet e anketuara kanë konstatuar të njëjtën tendencë negative, me përjashtim të Hungarisë, Serbisë dhe Spanjës, ku situata nuk ka ndryshuar, dhe të Greqisë, ku përqindja e romëve që përjetojnë diskriminim në arsim është ulur.

Është rritur numri i romëve në punësim me pagesë, por janë rritur gjithashtu hendeku gjinor dhe diskriminimi

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 5, synimet e Kuadrit të BE-së për Romët janë që, brenda vitit 2030:

- të reduktohet hendeku në punësim me të paktën 50% dhe të garantohet që të paktën 60% e romëve të jenë në punësim me pagesë;
- të reduktohet hendeku në punësim për romët me të paktën 50% për të garantuar që të paktën 45% e grave romë të jenë në punësim me pagesë;
- të reduktohet numri i të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim (NEET) me të paktën 50% dhe të garantohet që më pak se një në tre të rinj romë të jenë NEET.

Synimet strategjike të [Kuadrit të BE-së për Romët](#) nënvizojnë detyrimet që lindin nga dispozitat e Direktivës së riformuluar 2006/54/KE, "Për zbatimin e parimit të mundësive dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesioneve", e cila përcakton ndalimin e diskriminimit dhe ngacmimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me bazë gjinor, si dhe të ngacmimit seksual lidhur me pagën, (aksesin në) punësimin dhe skemat e sigurimeve shoqërore. Objektivat janë gjithashtu në përputhje me detyrimet e parashikuara në Direktivën 2000/43/BE, "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht racës ose origjinës etnike". Kjo direktivë ndalon diskriminimin mbi bazat e racës ose të origjinës etnike në një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë në fushat e punësimit, mbrojtjes sociale, përfitimeve sociale, arsimit, mallrave dhe shërbimeve të disponueshme për publikun, si dhe strehimit.

Në përgjithësi, situata lidhur me punësimin e romëve/udhëtarëve është përmirësuar krahasuar me vitin 2016. Duket se pothuajse të gjitha synimet në nivel BE-je mund të arrihen brenda vitit 2030. Megjithatë, janë rritur hendeku gjinor në punësim dhe diskriminimi. Romët që jetojnë në lagjet jorome janë në situatë më të mirë në tregun e punës se ata që jetojnë në lagjet ku të gjithë ose shumica e njerëzve janë romë, veçanërisht në Shqipëri, Republikën Çeke, Hungari, Portugali dhe Rumani.

- Në vitin 2024, një në dy romë/udhëtarë të grupmoshës 20–64 vjeç (54%) ishin në punësim me pagesë. Këtu përfshihet puna me kohë të plotë, puna me kohë të pjesshme, vetëpunësimi ose puna rastësore, si dhe kryerja e punëve të posaçme (ad-hoc), ose të punuarit në katër javët e fundit. Kjo shifër përbën përmirësim krahasuar me përqindjen e vitit 2016 (43%), por sërish mbetet më pak se tre të katërtat e përqindjes në rastin e popullit të thjeshtë në BE (75% në vitin 2023 dhe 73% në vitin 2018). Një tendencë pozitive është konstatuar në të gjitha vendet e anketuara, përveçse në Portugali, ku tendenca është negative, si dhe në Francë, Greqi dhe Serbi, ku përqindja nuk ka ndryshuar.
- Nivelet e punësimit janë rritur si për gratë po ashtu dhe për burrat romë. Në vitin 2024, 38% e grave romë/udhëtare të grupmoshës 20–64 vjeç ishin të punësuar, ndërsa në rastin e burrave romë/udhëtarë të së njëjtës grupmoshë, kjo shifër ishte 69%. Megjithatë, hendeku gjinor (31 pikë përqindje) është rritur që nga viti 2016 (27 pikë përqindje). Katër vende kanë arritur synimin në nivel BE-je për punësimin e grave romë: Bullgaria (49%), Republika Çeke (45%), Hungaria (53%) dhe Italia (45%).
- Një në dy të rinj (të grupmoshës 16–24) romë/udhëtarë (47%) janë NEET, një rënie e konsiderueshme krahasuar me nivelin prej 62% në vitin 2016. Megjithatë, kjo shifër është ende pesë herë më e lartë se në rastin e popullit të thjeshtë të BE-27 (9% në vitin 2023 dhe 10% në vitin 2018). Tendencë negative është konstatuar vetëm në Portugali dhe Serbi. Në Republikën Çeke, Greqi dhe Irlandë (për udhëtarët), situata nuk ka ndryshuar.
- Një në tre romë/udhëtarë mbi 16 vjeç (36%) janë ndjerë të diskriminuar në momentin që kanë kërkuar punë, për shkak të faktit se janë romë/udhëtarë, gjatë 12 muajve të fundit përpara anketës – më tepër se dyfishi krahasuar me vitin 2016 (16%). Niveli i diskriminimit është disi më i ulët në momentin që fillojnë punë. Dy në pesë romë/udhëtarë mbi 16 vjeç (22%) janë ndjerë të diskriminuar në vendin e punës për shkak të faktit se janë romë/udhëtarë, gjatë 12 muajve përpara anketës. Kjo shifër është katër herë më e lartë se në vitin 2016 (5%). Çdo vend anëtar i anketuar shfaq të njëjtën tendencë negative në të dy treguesit.

Hendeku i jetëgjatësisë ndërmjet romëve dhe popullit të thjeshtë është ulur

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 6, synimi i Kuadrit të BE-së për Romët është që, brenda vitit 2030:

- të reduktohet me të paktën 50% hendeku i jetëgjatësisë dhe të garantohet që gratë dhe burrat romë të jetojnë pesë vite më shumë.

Objektivi lidhet me nenin 1 të [Kartës së të Drejtave Themelore](#) si një parim gjithëpërfshirës, si dhe me të drejtën për jetën që garantohet nga neni 2 i Kartës. Në përgjithësi, ai lidhet gjithashtu me të drejtën për të pasur akses në kujdes shëndetësor parandalues dhe me të drejtën për të marrë trajtim mjekësor sipas kushteve të përcaktuara në ligjet dhe praktikat kombëtare, siç garantohet nga neni 35 i [Kartës](#), pasi këto aspekte janë të ndërlidhura me jetëgjatësinë. Për më tepër, objektivi lidhet me detyrimin politik të parashikuar në [Shtyllën Evropiane për të Drejtat Sociale](#). Edhe pse Shtylla Evropiane për të Drejtat Sociale nuk e trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë aspektin e jetëgjatësisë, parimet e saj dhe masat mbrojtëse lidhur me të drejtat mund të kontribuojnë në një jetë më të gjatë dhe të shëndetshme duke promovuar aksesin në kujdes shëndetësor, mbrojtjen sociale dhe mjedisin mbështetës. [Kuadri i BE-së për Romët](#) formulon nevojën për përshtatjen e këtyre objektivave politike për komunitetin rom.

Edhe pse të dhënat e Anketës për Romët 2024 sugjerojnë një reduktim të vogël të hendekut ndërmjet romëve/udhëtarëve dhe popullit të thjeshtë lidhur me jetëgjatësinë në lindje, synimi në nivel BE-je nuk ka gjasa të arrihet brenda vitit 2030.

- Jetëgjatësia e grave romë/udhëtare është 7,4 vite më e ulët se e grave nga populli i thjeshtë, ndërsa jetëgjatësia e burrave romë/udhëtarë është 8,0 vite më e ulët se e burrave nga populli i thjeshtë (në vitin 2017, ky hendek ishte 8,0 vite për gratë dhe 8,5 vite për burrat). Në të gjitha vendet e mbuluara nga anketa u konstatua një tendencë në rënie e këtij hendeku. Jetëgjatësia për gratë romë/udhëtare në vendet anëtare të mbuluara është mesatarisht 75,6 vite (74,6 në vitin 2017), ndërsa për burrat romë/udhëtarë është 69,2 vite (68,3 në vitin 2017).
- Tre në katër romë/udhëtarë (74%) në vendet anëtare të anketuara kanë sigurim shëndetësor në shtetin përkatës. Nuk ka pasur ndryshime në këtë drejtim që nga

viti 2016 (73%). Ekziston një tendencë pozitive në Bullgari, Republikën Çeke, Greqi, Hungari, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në vendet e tjera, situata nuk ka ndryshuar.

- 16% e romëve/udhëtarëve janë ndjerë të diskriminuar mbi bazën e origjinë së tyre si romë/udhëtarë, në rastet kur kanë aksesuar shërbime shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit. Kjo shifër është dy herë më e lartë se në vitin 2016 (8%). Të gjitha vendet e anketuara shfaqin të njëjtën tendencë negative, me përjashtim të Greqisë, Rumanisë, Serbisë dhe Spanjës, ku situata nuk ka ndryshuar.

Kushtet e strehimit për romët po përmirësohen

KUADRI I BE-SË PËR ROMËT

Në kuadër të objektivit 7, synimet e Kuadrit të BE-së për Romët janë që, brenda vitit 2030:

- të reduktohet me të paktën një të tretën hendeku ndërmjet romëve dhe popullit të thjeshtë lidhur me privimin nga strehimi dhe të garantohet që shumica e romëve të mos përballen me privim nga strehimi;
- të reduktohet me të paktën 50% hendeku ndërmjet romëve dhe popullit të thjeshtë lidhur me jetesën në banesa të mbipopulluara dhe të garantohet që shumica e romëve të mos jetojnë në banesa të mbipopulluara;
- të garantohet që të paktën 95% e romëve të kenë akses në ujë rubineti.

Synimet për objektivin 7 kërkojnë të garantojnë një ekzistencë të denjë për të gjithë personat që nuk kanë burime të mjaftueshme, në përputhje me nenin 34 të [Kartës së të Drejtave Themelore](#) dhe me rregullat e përcaktuara në legjislacionin e BE-së dhe ligjet e praktikave kombëtare. Ato rikonfirmojnë detyrimet e BE-së dhe të vendeve anëtare për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë, duke njohur dhe respektuar të drejtën për asistencë sociale dhe për strehim.

Në përgjithësi, situata e strehimit për romët/udhëtarët është përmirësuar që nga viti 2016. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë dallime në nivel kombëtar. Synimet në nivel BE-je mund të arrihen në shumicën e vendeve lidhur me privimin nga strehimi dhe aksesin në ujë rubineti, por jo lidhur me mbipopullimin. Fëmijët (grupmosha 15 vjeç e poshtë) përballen me kushte strehimi më të këqija krahasuar me romët/udhëtarët e tjerë. Shpeshherë, jetesa në lagje jorome rezulton në kushte strehimi më të mira, akses në ujë rubineti dhe nivel më të ulët mbipopullimi se sa jetesa në zona ku mbizotërojnë romët/udhëtarët.

- Një në dy romë/udhëtarë (47%) jeton në një situatë të privimit nga strehimi, pra, në banesa ose strehime të errëta dhe me lagështi, si dhe pa ambiente të përshtatshme sanitare. Kjo shifër është përmirësuar që nga viti 2016 (61%), por është shumë më e lartë se norma prej 18% për popullin e thjeshtë në BE për vitet 2023 dhe 2018. Anketa për Romët 2024 konfirmon një tendencë në rënie krahasuar me vitin 2016, në pothuajse të gjitha vendet e anketuara. Një tendencë

në rritje është identifikuar vetëm në Francë dhe Portugali, ndërsa në Irlandë (për udhëtarët) dhe Spanjë nuk ka ndryshime.

- Katër nga pesë romë/udhëtarë (83%) jetojnë në një banesë që nuk ka mjaftueshëm dhoma dhe që është e mbipopulluar. Kjo shifër ka ndryshuar pak që nga viti 2016 (78%). Ky nivel është pothuajse pesë herë më i lartë se përqindja për popullin e thjeshtë në BE për vitet 2024 dhe 2018 (17%). Të dhënat tregojnë se nuk ka ndryshim pozitiv krahasuar me vitet e mëparshme në të gjitha vendet e anketuara, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut.
- Një në pesë romë/udhëtarë (17%) jetojnë pa ujë rubineti brenda akomodimit të tyre, çka përbën një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2016 (30%). Progresi ka ardhur kryesisht si pasojë e reduktimeve të konsiderueshme në Hungari dhe Rumani. Përqindja është ende tetë herë më e lartë se sa në rastin e popullit të thjeshtë në BE-27 për vitet 2023 dhe 2018 (2%). Tendenca është negative vetëm në Maqedoninë e Veriut. Në vendet e tjera, tendenca është pozitive ose nuk ka ndryshime.
- Një në tre romë/udhëtarë (35%) kanë përjetuar diskriminim për shkak të origjinës së tyre etnike në rastet kur kanë kërkuar strehim, çka përbën një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2016 (41%). Në nivel kombëtar, e njëjta tendencë në rënie është konstatuar në vetëm dy nga vendet e anketuara, përkatësisht Republika Çeke dhe Spanja. Në Bullgari, Francë, Hungari dhe Rumani, situata është përkeqësuar.

Përfundimet

Ky raport paraqet evidenca mbi mënyrën se si ushtrojnë të drejtat e tyre themelore romët/udhëtarët në vendet e përzgjedhura evropiane. Ai eksploron ndikimin që kanë masat dhe veprimtaritë e institucioneve të BE-së dhe të vendeve individuale përgjegjëse në ndryshimet e përvojave të personave që zotërojnë të drejta. Rezultatet duhet të merren në konsideratë në kontekstin e legjislacionit në fuqi të BE-së për të drejtat themelore, në veçanti [Karta e të Drejtave Themelore](#) dhe [Shtylla Evropiane për të Drejtat Sociale](#), si dhe në kontekstin e OZhQ-ve të Kombeve të Bashkuara.

Ky raport prezanton të dhëna për romët dhe udhëtarët në mesin e afatit kohor të [Kudrit të BE-së për Romët](#), të cilat janë mbledhur përmes Anketës për Romët 2024 të FRA-së në dhjetë vende anëtare dhe në tre vende në proces anëtarësimi. Anketa është strukturuar bazuar në objektivat e këtij kuadri të politikave.

Të dhënat nga Anketa për Romët 2024 sugjerojnë se, mesatarisht në 10 vendet anëtare të studiuara, janë bërë përmirësime në aksesin e romëve/udhëtarëve në të drejtat themelore që nga viti 2016 (2019 në rastin e Francës dhe Irlandës) për sa i përket 10 nga 16 treguesve kryesorë të përdorur për monitorimin në [Kudrin e BE-së për Romët](#). Kjo do të thotë se në vitin 2024, romët dhe udhëtarët kanë pasur më shumë akses në disa të drejta se sa në të kaluarën. Këtu përfshihet e drejta për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e individëve dhe të familjeve të tyre (përmirësim i pjesshëm), e drejta për arsimim (përmirësim i pjesshëm), e drejta për punësim (përmirësim i pjesshëm), si dhe e drejta për akses në kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të përfituar nga trajtimi mjekësor.

Situata është përkeqësuar për sa i përket raportimit të diskriminimit, pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimimit mbi institucionet për të drejtat e njeriut dhe rritjes së besimit të sistemi ligjor dhe policia. Nuk janë konstatuar ndryshime në pesë tregues, të cilët lidhen me synimet për diskriminimin (në tërësi dhe në fushat individuale të jetës), veçimin në arsim, barazinë gjinore në punësim dhe mbipopullimin. Katër të parat lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e garantuara nga legjislacioni i BE-së për të drejtat e njeriut i përmendur më sipër. Të dhënat sugjerojnë gjithashtu se COVID-19 ka pasur një ndikim të madh mbi romët në të gjitha vendet e anketuara.

Raporti paraqet një sërë zhvillimesh pozitive, të cilat janë të gjitha të lidhura me të drejtat e përmendura më sipër. Këto zhvillime pozitive përfshijnë uljen e numrit të romëve/udhëtarëve që përjetojnë varfëri, privim material dhe privim nga strehimi, rritjen e numrit të romëve/udhëtarëve që kanë besim te policia apo te sistemi ligjor në vendin e tyre, rritjen e numrit të fëmijëve romë/udhëtarë që frekuentojnë arsimin në

fëmijërinë të hershme, rritjen e numrit të romëve në punësim me pagesë dhe uljen e hendekut ndërmjet romëve/udhëtarëve dhe popullit të thjeshtë për sa i përket jetëgjatësisë në lindje.

Megjithatë, ka ende fusha që shfaqin zhvillime negative lidhur me aksesin e romëve/udhëtarëve në të drejtat themelore. Gjatë dekadës së fundit, romët/udhëtarët në të gjitha vendet e anketuara janë përballur me rritje të niveleve të diskriminimit. Ky është një fakt i vërtetë në tërësi, por në veçanti lidhur me aksesin e tyre në të drejta të caktuara socio-ekonomike (arsimimi, punësimi, shëndeti dhe strehimi). Fëmijët romë/udhëtarë vazhdojnë të arsimohen në një masë të madhe në ambiente të veçuara dhe romët/udhëtarët vijojnë të jetojnë shpesh në banesa të mbipopulluara.

Të dhënat sugjerojnë se shumica e objektivave në nivel BE-je, të përcaktuar nga [Kuadri i BE-së për Romët](#), për rritjen e aksesit të barabartë në punësim cilësor dhe të qëndrueshëm, kanë gjasa të arrihen brenda vitit 2030. Megjithatë, gjashtë objektivat e tjerë në nivel BE-je nuk ka gjasa të arrihen brenda atij viti. Asnjë vend nuk ka gjasa që t'i arrijë objektivat e caktuar në nivel BE-je për antixhizmin dhe diskriminimin, pjesëmarrjen ose shëndetin. Dy vende kanë gjasa t'i arrijnë objektivat në nivel BE-je për varfërinë dhe përjashtimin social (Bullgaria dhe Hungaria) dhe për arsimin (Bullgaria dhe Italia). Katër vende kanë gjasa t'i arrijnë objektivat për punësimin (Bullgaria, Hungaria, Italia dhe Rumania) dhe për strehimin (Republika Çeke, Greqia, Italia dhe Spanja). Një vështrim më nga afër i objektivave individuale tregon se të gjitha vendet hasin më shumë vështirësi me objektivat e lidhur me mbylljen e hendekut midis romëve/udhëtarëve dhe popullit të thjeshtë.

Ky raport nuk do të ishte në gjendje të prezantonte tendencat në aksesin e romëve/udhëtarëve në të drejtat themelore nëse FRA-ja nuk do të kishte mbledhur në mënyrë të rregullt të dhëna statistikore për romët/udhëtarët. FRA-ja inkurajon vendet anëtare që të marrin në dorë mbledhjen e të dhënave për romët/udhëtarët dhe është e gatshme të ofrojë asistencë teknike për të avancuar në përmbushjen e këtij objekti.

Shënimet e fundfaqes

-
- (¹) [Versioni i konsoliduar i Traktatit për Bashkimin Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 13), Nenet 2 dhe 6.
- (²) [Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 47), Nenet 8, 9, 10 dhe 19.
- (³) [Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 391).
- (⁴) Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – [Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), COM(2020) 620 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020.
- (⁵) FRA, [EU-MIDIS – Raporti 1 "Të dhënat në fokus": Romët](#), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2009.
- (⁶) FRA, [Situata e romëve në 11 vende anëtare të BE-së – Vështrim mbi rezultatet e anketës](#), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2012.
- (⁷) FRA, [Anketa e dytë e Bashkimit Evropian për Pakicat dhe Diskriminimin – Rezultatet kryesore](#), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2017.
- (⁸) FRA, [Romët dhe udhëtarët në qjashtë vende – Anketa për Romët dhe Udhëtarët](#), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2020.
- (⁹) FRA, [Romët në 10 vende evropiane – Rezultatet kryesore – Anketa për Romët, 2021](#), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2022.
- (¹⁰) Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – [Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), COM(2020) 620 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020.
- (¹¹) [Rekomandimi i Këshillit, datë 12 mars 2021, për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve](#) (Gazeta Zyrtare C 93, 19.3.2021, f. 1).
- (¹²) Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – [Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), COM(2020) 620 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020, shtojca 2.
- (¹³) Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – [Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), COM(2020) 620 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020.
- (¹⁴) [Versioni i konsoliduar i Traktatit për Bashkimin Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 13), nenet 2 dhe 6; [Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 47), nenet 8, 9, 10 dhe 19; [Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian](#) (Gazeta Zyrtare C 326, 26.10.2012, f. 391).
- (¹⁵) [Direktiva e Këshillit 2000/43/KE, datë 29 qershor 2000, "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht racës ose origjinës etnike"](#) (Gazeta Zyrtare L 180, 19.7.2000, f. 22).

-
- (¹⁶) [Shpallja ndërinstitucionale e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale](#) (Gazeta Zyrtare C 428, 13.12.2017, f. 10).
- (¹⁷) Organizata e Kombeve të Bashkuara, [Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 25 shtator 2015 – Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm](#), f. 3.
- (¹⁸) Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – [Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), COM(2020) 620 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020.
- (¹⁹) Këshilli i Evropës, [Fjalor përshkrues i termave lidhur me çështjet rome](#), Strasburg, 2012.
- (²⁰) [Rregullorja e Këshillit \(BE\) 2022/555, datë 5 prill 2022, "Për ndryshimin e Rregullores \(KE\) nr. 168/2027 për krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore"](#) (Gazeta Zyrtare L 108, 7.4.2022, f. 1).
- (²¹) Ekipi Mbështetës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Çështjet e Romëve, dokumenti "[Vlerësimet dhe shifrat zyrtare të popullsisë rome në Evropë](#)", përditësuar së fundi më datë 2 korrik 2012.
- (²²) [Dokumenti analitik që shoqëron Komunikatën e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit – Një Bashkim Evropian i Barabartë: Kuadri Strategjik i BE-së për Romët lidhur me barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen](#), SWD(2020) 530 versioni përfundimtar, datë 7 tetor 2020, shtojca 2.
- (²³) FRA, [Pandemia e koronavirusit në BE – Ndikimi te romët dhe udhëtarët](#), Buletini nr. 5, Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2020.